

# PARANDALIMI DHE LUFTIMI I SEKSIZMIT



**Rekomandimi KM/Rek (2019)1**

# PARANDALIMI LUFTIMI I SEKSIZMIT

## **Rekomandimi KM/Rek (2019)1**

miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës

27 mars 2019

Këshilli i Evropës

---

Edicioni francez:

*Prevention et lutte contre le sexisme*

Riprodhimi i teksteve në këtë publikim është autorizuar me kusht që të citohet titulli i plotë dhe burimi, përkatësisht Këshilli i Evropës. Nëse ato synohen të përdoren për qëllime tregtare ose të përkthehen në ndonjëerën nga gjuhët jo zyrtare të Këshillit të Evropës, ju lutemi kontaktoni [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int).

Ballina dhe faqesja: Departamenti i Përgatitjes dhe Publikimit të Dokumenteve (SPDP), Këshilli i Evropës

© Këshilli i Evropës, Prill 2019  
ribotuar në qershor 2019

Shtypur në Këshill të Evropës



# Përmbajtja

---

<b>REKOMANDIMI CM/REC(2019)1</b>	<b>5</b>
<b>SHTOJCA E REKOMANDIMIT CM/REC(2019)1</b>	<b>10</b>
I. Mjetet dhe masat e përgjithshme për adresimin e seksizmit	13
I.A. Legjislacioni dhe politikat	13
I. B. Masat e vetëdijesimit	14
II. Mjete dhe masa specifike për adresimin e seksizmit dhe sjelljes seksiste <u>në zonat e synuara</u>	<u>16</u>
II. A. Gjuha dhe komunikimet	16
II.B. Gjuha seksiste dhe e urrejtjes në internet dhe rrjete sociale	17
II.C. Produkte dhe shërbime të tjera të komunikimit në media dhe reklamime	19
II.D. Vendi i punës	21
II.E. Sektori publik	23
II.F. Sektori i drejtësisë	24
II.G. Institucionet arsimore	25
II.H. Kultura dhe sporti	26
II.I. Sfera private	27
III. Raportimi dhe vlerësimi	29

---

# Rekomandimi

## KM/Rek(2019)1<sup>1</sup>

---

*(Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 27 korrik 2019  
në takimin e 1342-të të zëvendësministrave)*

Komiteti i Ministrave sipas Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke rikujtuar se barazia gjinore është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, funksionimin e demokracisë dhe qeverisjen e mirë, respektimin e sundimit të ligjit dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë, që ngërthen në vete të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, si dhe të njëjtin vizibilitet, fuqizim, përgjegjësi dhe pjesëmarrje në të gjitha sferat e jetës publike dhe private, dhe që nënkupton një qasje dhe ndarje të barabartë të burimeve midis grave dhe burrave, siç përcaktohet në Strategjinë e Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore 2018 -2023;

Duke rikujtuar se diskriminimi për shkak të seksit dhe/ose gjinisë përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe pengesë për realizimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të njohura nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për eliminimin e diskriminimit ndaj grave në Rekomandimin e tij të Përgjithshëm Nr. 28 për detyrimet themelore të shteteve palë, në bazë të nenit 2 të Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave;

Duke rikujtuar se seksizmi është një tregues i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave, gjë që rezulton në diskriminim dhe pengon përparimin e plotë të grave në shoqëri;

Duke vënë në pah se seksizmi është i përhapur dhe mbizotërues në të gjithë sektorët dhe të gjitha shoqëritë;

Duke pohuar se seksizmi përforcohet nga stereotipet gjinore që prekin gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, dhe shkon kundër arritjes së barazisë gjinore dhe shoqërive gjithëpërfshirëse;

Duke theksuar se seksizmi përbën një pengesë për fuqizimin e grave dhe vajzave, të cilat preken në mënyrë disproporcionale nga sjellje seksiste; dhe më tej duke vënë në dukje se stereotipet gjinore dhe paragjykimet e qenësishme formësojnë normat, sjelljen dhe pritjet e burrave dhe djemve, dhe si rrjedhojë çojnë në akte seksiste;

Të shqetësuar se seksizmi është i lidhur me dhunën ndaj grave dhe vajzave, përmes të cilit aktet e seksizmit "të përditshëm" bëhen pjesë e një vazhdimësie të dhunës duke krijuar një klimë kërcënimi, frikësimi, diskriminimi, përjashtimi dhe pasigurie që kufizon mundësitë dhe lirinë;

Duke theksuar që gratë dhe vajzat mund të jenë subjekt i formave të shumta dhe të ndërthurura të diskriminimit dhe mund të përballen me seksizëm të kombinuar me norma ose sjellje të tjera që janë diskriminuese, urrejtëse ose të dëmshme;

Të vetëdijshëm se seksizmi dhe sjellja seksiste kryhen në nivele individuale, institucionale dhe strukturore, dhe përjetohej me efekte të dëmshme në të tri nivelet, masat për parandalimin dhe luftën kundër e seksizmit duhet të merren në të gjitha nivelet;

Duke rikujtuar Konventën e Kombeve të Bashkuara të vitit 1979 për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), e cila kërkon që shtetet palë të ndërmarrin të gjitha masat e duhura "për të modifikuar modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së burrave dhe grave, me qëllim të arritjes së eliminimit të paragjyqimeve dhe të gjitha praktikave të tjera të zakonshme të cilat bazohen në idenë e

---

<sup>1</sup> Kur u miratua ky Rekomandim dhe në zbatim të nenit 10.2c të Rregullores së Punës për mbledhjet e Zëvendësministrave, Përfaqësuesi i Federatës Ruse rezervoi të drejtën e qeverisë së tij që ta respektojë ose jo Rekomandimin, veçanërisht paragrafin 3 të Preambulës, duke refuzuar përdorimin e termit "gjini", pasi legjislacioni rus nuk përmban konceptin e "gjinisë" dhe duke pasur parasysh faktin se nuk ka një përkufizim të pranuar zakonisht të termit "gjini" në nivelin ndërkombëtar. Veç kësaj, Federata Ruse konsideron që personat interseksualë dhe transseksualë nuk hyjnë në fushën e Rekomandimit.

inferioritetit ose epërsisë nga ndonjëra prej gjinive ose në role të stereotipizuara për burrat dhe gratë";

Duke patur parasysh objektivat e paraqitura në Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim të miratuar nga Konferenca e katërt Botërore e Kombeve të Bashkuara për Gratë (1995), dhe veçanërisht Raportin e Takimit Shqyrtues Rajonal në Pekin+20 për Evropë, të organizuar nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë në vitin 2014, i cili tregoi se "stereotipet diskriminuese mbeten të përhapura dhe ndikojnë në edukimin dhe pjesëmarrjen e grave në ekonomi dhe në jetën publike";

Duke patur parasysh Rendin e punimeve të Kombeve të Bashkuara 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, përfshirë Qëllimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm 5 ("Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimit të të gjitha grave dhe vajzave"). Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 16 ("Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, sigurimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe krijimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet") dhe Qëllimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 4 ("Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës, të barabartë e cilësor dhe promovimi mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë"), të cilat vlejnë për gjithë botën;

Duke patur parasysh Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (1989) dhe ndalimin nga ana e saj të diskriminimit bazuar në gjininë e fëmijës ose të prindit të tij/saj ose të kujdestarit ligjor;

Duke rikujtuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ETS Nr. 5) e cila ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave të njeriut;

Duke rikujtuar se lufta kundër stereotipeve gjinore dhe seksizmit dhe sigurimi i integritetit të perspektivës së barazisë gjinore në të gjitha politikat dhe masat janë objektiva prioritare në dokumentet dhe rekomandimet e Strategjisë së Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore;

Duke rikujtuar se Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (CETS Nr. 210, Konventa e Stambollit) kërkon që palët "të promovojnë ndryshime në modelet shoqërore dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave me qëllim eliminimin e paragjytimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera të cilat bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në role stereotipeshe për gra dhe burra", dhe se Konventa e Stambollit gjithashtu kërkon që palët të kriminalizojnë ngacmimin dhe të marrin masat e nevojshme për të siguruar që ngacmimet seksuale iu nënshtrohen sanksioneve të duhura ligjore ose penale ;

Duke marrë parasysh Kartën Sociale Evropiane (ETS Nr. 35, ETS Nr. 163 [të rishikuar]) dhe dispozitat e saj për mundësi të barabarta, mos-diskriminim dhe për të drejtën e dinjitetit në punë;

Duke rikujtuar se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në praktikën e saj gjyqësore ka ritheksuar se avancimi i barazisë gjinore është sot qëllim kryesor në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe se referenca ndaj traditave, supozimeve të përgjithshme ose qëndrimeve mbizotëruese sociale janë justifikim i pamjaftueshëm për dallime në trajtime në baza gjinore. Për më tepër, Gjykata ka treguar që stereotipet gjinore, siç është perceptimi i grave si kryesoret për t'u kujdesur për fëmijët dhe për burrat si mbajtës kryesor të familjes, nuk mund të justifikojnë vetvetiu një ndryshim në trajtim;

Duke rikujtuar rekomandimet e mëposhtme të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare: CM/Rec(2007)13 për integrimin e dimensionit gjinor në arsim; KM/Rek(2007)17 për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore; KM/Rek(2013)1 për barazinë gjinore dhe mediat; dhe KM/Rek(2017)9 për barazinë gjinore në sektorin audiovizual;

Duke iu referuar Rekomandimit të Politikës së Përgjithshme Nr.15 për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, të miratuar nga Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në dhjetor 2015, i cili përfshin gjuhën e urrejtjes seksiste;

Duke marrë parasysh Strategjinë e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Fëmijëve (2016-2021), e cila thekson nevojën për të luftuar diskriminimin dhe dhunën, veçanërisht dhunën seksuale dhe nevojën për të promovuar barazinë midis vajzave dhe djemve, përfshirë adresimin e vazhdueshëm të stereotipeve, seksizmit dhe seksualizimit të tepruar, veçanërisht në media dhe arsim;

Duke marrë parasysh Strategjinë e Këshillit të Evropës për Kontroll të Internetit 2016-2019 dhe thirrjen e saj për veprim monitorimi për të mbrojtur të gjithë, në veçanti gratë dhe fëmijët, nga abuzimi në internet, përfshirë sulmet në internet, seksizmin dhe kërcënimet për dhunë seksuale;

Duke kujtuar Rezolutat 2119 (2016), 2144 (2017) dhe 2177 (2017) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, përkatësisht për të "luftuar seksualizimin e tepruar të fëmijëve", "Ndalimin e diskriminimit kibernetik dhe urrejtjes në internet" dhe "Ndalimin dhunës seksuale dhe ngacmimit të grave në hapësirën publike";

Duke u bazuar në rezultatet e vënies në zbatim të instrumenteve dhe dokumenteve të lartpërmendura në

nivele ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë arritjet dhe sfidat;

Të vetëdijshëm se me gjithë ekzistencën e standardeve në nivelin ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal që garantojnë parimin e barazisë gjinore, ende ekziston një hendek midis standardeve dhe praktikës, midis barazisë gjinore de jure dhe de fakto;

Duke pranuar që mbizotërimi i shfaqjeve të ndryshme të seksizmit është i lidhur ngushtë me vështirësitë e vazhdueshme në arritjen e barazisë gjinore, me dëshirën për ta trajtuar seksizmin si çështje kritike dhe pasojë e pabarazisë gjinore;

Duke theksuar mungesën e një përkufizimi të pranuar ndërkombëtarisht për "seksizmin" dhe të një instrumenti ligjor të përkushtuar për ta trajtuar atë;

Duke synuar krijimin e një Evrope të lirë nga seksizmi dhe shfaqjet e tij,

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

1. Të ndërmarrin masa për ta parandaluar dhe luftuar seksizmin dhe shfaqjet e tij në sferat publike dhe private dhe të inkurajojnë partnerët përkatës të zbatojnë legjislacionin, politikat dhe programet e duhura duke u bazuar në përkufizimin dhe udhëzimet e bashkëngjitura në këtë Rekomandim;
  2. Të monitorojnë progresin në zbatimin e këtij Rekomandimi dhe të informojnë Komitetin(et) Drejtues kompetent(e) të Këshillit të Evropës për masat e ndërmarra dhe progresin e arritur në këtë fushë;
  3. Të sigurojnë që ky Rekomandim, përfshirë shtojcën e tij, të përkthehet dhe t'iu shpërndahet (në formate të përdorshëm autoriteteve përkatëse dhe palëve të interesuara.
-



## Shtojca e Rekomandimit [KM/Rek\(2019\)1](#)

Udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër e seksizmit: masat për zbatim

### Përkufizimi

Për qëllime të këtij Rekomandimi, seksizmi nënkupton:

Çdo veprim, gjest, paraqitje vizuale, fjalë të thëna ose të shkruara, praktikë ose sjellje të bazuar në idenë se një person ose një grup personash është inferior për shkak të gjinisë së tyre, që ndodhë në sferën publike ose private, qoftë online apo offline, me qëllim ose efekt:

- i. të shkeljes së dinjitetit ose të drejtave thelbësore të një personi ose një grupi personash; ose
- ii. që rezulton me dëm fizik, seksual, psikologjik ose socio-ekonomik ose vuajtje për një person ose një grup personash; ose
- iii. të krijimit të një mjedisi frikësues, armiqësor, poshtërues, ofendues ose fyes; ose
- iv. të krijimit të një pengese për autonominë dhe realizimin e plotë të të drejtave të njeriut nga një person ose një grup personash; ose
- v. ruajtjes apo forcimit të stereotipeve gjinore.<sup>2</sup>

### Konteksti

Nevoja për ta trajtuar seksizmin, normat dhe sjelljet seksiste dhe gjuhën seksiste është e nënkuptuar në një varg instrumentesh ndërkombëtare dhe rajonale. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (CETS Nr. 210, Konventa e Stambollit), ashtu si dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) njohin një vazhdimësi mes stereotipeve gjinore, pabarazisë gjinore, seksizmit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave. Në këtë mënyrë, aktet e seksizmit "të përditshëm" në formën e sjelljeve, komenteve dhe shakave seksiste, në dukje të vogla dhe të padëmshme, janë ne skaj të kësaj vazhdimësie. Megjithatë, këto akte shpesh janë poshtëruese dhe kontribuojnë në një klimë sociale ku gratë përulen, vetëvlerësimi i tyre ulet dhe aktivitetet dhe zgjedhjet e tyre kufizohen, përfshirë në punë, në sferën private, publike ose në internet. Sjellja seksiste, e sidomos gjuha e urrejtjes seksiste, mund të përshkallëzohet ose të nxisë veprime të qarta fyese dhe kërcënuese, përfshirë abuzimin seksual ose dhunën, përdhunimin ose ndonjë veprim që mund të jetë vdekjeprurës. Pasoja të tjera mund të përfshijnë humbjen e burimeve të jetesës, vetë-dëmtimin ose vetëvrasjen. Prandaj trajtimi i seksizmit është pjesë e detyrimit pozitiv të shteteve për të garantuar të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe për të parandaluar dhunën ndaj grave dhe vajzave në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe për shtetet palë të Konventës së Stambollit.

Seksizmi dhe sjellja seksiste rezultojnë në dëmtime fizike, seksuale, psikologjike ose socio-ekonomike dhe ndikojnë në mënyra të ndryshme në sektorë të caktuar të popullatës. Gratë dhe vajzat preken në mënyrë disproporcionale nga sjellje të tilla. Seksizmi dhe sjellja seksiste përbëjnë pengesë për fuqizimin dhe përparimin e grave dhe vajzave; nga eliminimi i seksizmit dhe sjelljes seksiste do të përfitonin të gjithë: gratë, vajzat, burrat dhe djemtë.

Seksizmi dhe sjellja seksiste është e shprehur thuajse në të gjitha aktivitetet njerëzore, përfshirë hapësirën kibernetike (internet dhe media sociale). Ato mund të përjetojnë individualisht ose kolektivisht nga një person ose një grup personash, edhe nëse as individit dhe as grupit nuk kanë qenë në shënjestër të drejtpërdrejtë, për shembull përmes reklamave seksiste, ose postimit të fotografive të grave lakuriq në vendin e punës. Të tri nivelet si përforcohet dhe përjetohet seksizmi janë: individuale, institucionale (për shembull familja, puna ose mjedisi arsimor), dhe strukturore (për shembull përmes pabarazive gjinore shoqërore, normave shoqërore dhe sjelljes). Seksizmi mbetet ne heshtje kur individët dhe grupet nuk e raportojnë atë ose nuk ankohen ndaj sjelljes seksiste nga frika se nuk merren seriozisht, se perjashtohen

---

<sup>2</sup> "Stereotipet gjinore janë modele të vjetëruara sociale ose kulturore ose ide me anë të të cilave grave dhe burrave u caktohen karakteristika dhe role të përcaktuara dhe të kufizuara nga gjinia e tyre. Stereotipizimi gjinor paraqet pengesë serioze për arritjen e barazisë së njëmendtë gjinore dhe ushqehet nga diskriminimi gjinor. Stereotipizimet e tilla mund të kufizojë zhvillimin e talenteve dhe aftësive natyrore të vajzave dhe djemve, grave dhe burrave, preferencat dhe përvojat e tyre arsimore dhe profesionale, si dhe mundësitë e jetës në përgjithësi". (Strategjia e Këshillit të Evropës për Barazi Gjinore 2018-2023, Objektivi Strategjik 1)

ose mbahen përgjegjës.

Interneti ka krijuar një dimension të ri për shprehjen dhe transmetimin e seksizmit, veçanërisht të gjuhës së urrejtjes seksiste, për një audiencë të madhe, edhe pse rrënjët e seksizmit nuk qëndrojnë në teknologji, por në pabarazi të vazhdueshme gjinore. Veç kësaj, fenomenet sociale siç është fushata #MeToo dhe një varg veprimesh dhe masash të politikave që ajo ka shkaktuar në pjesë të ndryshme të botës (nga 2017 e tutje), përfshirë edhe shtete anëtare të Këshillit të Evropës, kanë ndihmuar të hedhin dritë mbi përhapjen e seksizmit dhe nevojën për masa më të forta për ta luftuar atë.

Seksizmi dhe sjellja seksiste janë të rrënjësura në stereotipe gjinore dhe i forcojnë ato. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konsideron se "çështja me stereotipizimin të një grupi të caktuar në shoqëri qëndron në faktin se ajo ndalon vlerësimin e individualizuar të kapaciteteve dhe nevojave të tyre"<sup>3</sup>. Stereotipet gjinore forcojnë strukturat e pabarabarta të pushtetit shoqëror dhe ndikojnë negativisht në shpërndarjen e burimeve midis grave dhe burrave. Dallimi i vazhdueshëm në paga dhe pensione mes gjinive në Shtetet Anëtare e dëshmon këtë më së miri. Stereotipet gjinore janë pra konstruktive shoqërore të roleve "të përshtatshme" për gratë dhe burrat, të cilat përcaktohen nga paragjykimet kulturore, zakonet, traditat dhe në shumë raste, interpretimet e besimeve dhe praktikave fetare.

Gratë që sfidojnë ose devijojnë nga ajo që vlerësohet si vendi i tyre "i duhur" në shoqëri, mund të përballen me seksizëm dhe misogjeni dhe burrat që sfidojnë perceptimet mbizotëruese për maskulinitetin mund të përballen me seksizëm.

### **Ndërthurja, dobësitë e lidhura me situatën dhe rrethanat rënduese**

Gratë dhe burrat mund të ballafaqohen me forma të ndryshme dhe të ndërthurura të seksizmit, bazuar në një sërë faktorësh të tjerë duke përfshirë, mes tjerash, etninë, statusin e të qenit pakicë ose autokton, moshën, fenë, statusin e refugjatit ose emigrantit, aftësinë e kufizuar, statusin martesor, origjinën sociale, identitetin gjinor, orientimin seksual ose seksualitetin. Ata mund të ndodhen në situata më të rrezikuara ose të jenë në shënjestër të akteve të ndryshme të seksizmit në mjedise të ndryshme, si gratë e reja dhe gratë aktive në mjedise të dominuara nga meshkujt, për shembull në biznes, financa, ushtri ose politikë. Gratë në pozita të pushtetit ose autoritetit, përfshirë personalitetet publike, janë gjithashtu shënjestër e veçantë e seksizmit pasi ato perceptohen se kanë devijuar nga normat shoqërore të gjinisë që përjashtojnë gratë nga hapësirat publike ose autoriteti. Personat interseksualë dhe trans-seksualë gjithashtu përballen me sfida shtesë dhe/ose të zgjeruara në lidhje me seksizmin.

Disa rrethana mund të shtojnë seriozitetin ose ndikimin e sjelljes seksiste, ose mund të ndikojnë në aftësinë e viktimës për të reaguar. Rrethana të tilla rënduese ekzistojnë kur aktet apo fjalët seksiste ndodhin brenda një marrëdhënie hierarkike ose të varur, veçanërisht në punë, në një mjedis arsimor ose mjekësor, në kuader të shërbimeve (publike) ose të raporteve tregtare. Seksizmi është veçanërisht i dëmshëm kur autori është në një pozitë të pushtetit, autoritetit ose ndikimit të tillë si politikan, opinionist ose drejtues biznesi. Një faktor tjetër rëndues është aty ku shtrirja, ose arritja e mundshme, e gjuhës apo akteve seksiste është e gjerë, përfshirë mjetet e transmetimit, përdorimin e mediave sociale ose ato të transmetimit masiv dhe shkallën e përsëritjes.

## **I. Mjetet dhe masat e përgjithshme për adresimin e seksizmit**

Qëllimi kryesor i masave për të parandaluar dhe luftuar seksizmin është të nxisë ndryshimin në sjellje dhe kulturë në nivele individuale, institucionale dhe strukturore.

Mjetet për ta parandaluar dhe luftuar seksizmin përveç planeve, politikave dhe programeve mund të përfshijnë dhe instrumente legjislative, ekzekutive, administrative, buxhetore dhe rregullatore,. Shtetet duhet të zgjedhin mjetet më të përshtatshme me kontekstin e tyre si dhe objektivat e veprimeve të veçanta që duhet të ndërmarrin. Mjete të ndryshme janë të nevojshme për të adresuar, në njërin anë, paragjykimin e pavetëdijshëm dhe, në anë tjetër, sjelljen e qëllimshme seksiste. E para mund të adresohet përmes rritjes së ndergjegjesimit, trajnimit dhe edukimit, ndërsa masa më të forta janë të nevojshme për të eliminuar sjelljen e qëllimshme dhe të vazhdueshme seksiste dhe gjuhën e urrejtjes seksiste. Legjislacioni që adreson seksizmin, përfshirë përkufizimet; një udhëzues për përdorues; dhe një tregues i rrugëve të ndihmës dhe dëmshpërblimit për viktimat, dhe rreziqet dhe pasojat për autorët e

---

<sup>3</sup> *Carvalho Pinto de Sousa Moral kundër Portugalisë*, kërkesa nr. 17484/15, aktgjykim i 25 korrikut 2017 i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, paragrafi 46.

krimin, janë opsione të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë.<sup>4</sup>

Shtetet duhet të përdorin mjetet ekzistuese dhe të sigurojnë zbatimin e tyre efektiv ose të vënë në dispozicion mjete të reja për ta parandaluar sjelljen seksiste dhe për t'u mbrojtur prej saj, kur është e përshtatshme, të ndjekin penalisht shkelësit dhe të sigurojnë dëmshpërblim për viktimat.

Qeveritë e shteteve anëtare janë ftuar të shqyrtojnë masat e mëposhtme për të mbështetur zbatimin e këtij Rekomandimi.

### **I.A. Legjislacionin dhe politikat**

I.A.1. Të konsiderojnë reforma legjislative që dënojnë seksizmin dhe që përkufizojnë dhe kriminalizojnë të urretjes seksiste.

I.A.2. Faktorët ndërthurës, dallimet mes grave, dobësitë e rastit dhe rrethanat rënduese duhet të njihen dhe merren parasysh kur hartohen legjislacioni dhe politikat për ta luftuar seksizmin.

I.A.3. Krijimin dhe investimin në një infrastrukturë publike gjithëpërfshirëse që shërben si platformë për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore dhe zhvillimin e një kornize politike për eliminimin e seksizmit dhe stereotipet diskriminuese gjinore, me objektiva të qarta, standarde, afate kohore, tregues të progresit dhe rezultateve dhe një mekanizëm për monitorim dhe vlerësim të ndikimit të hapave të ndërmarrë.

I.A.4. Inkurajimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, në veçanti të grave, organizatave joqeveritare, udhëheqësve fetarë dhe të komunitetit, organeve profesionale të avokatëve dhe gjyqtarëve dhe sindikatave të punës në hartimin e politikave dhe kornizave ligjore që synojnë luftimin e seksizmit, në mënyrë që të promovojnë bashkëpunimin dhe të sigurojnë angazhimin e tyre në zbatimin e këtyre masave.

I.A.5. Të pranojnë, inkurajojnë dhe ta mbështesin punën e organizatave përkatëse të shoqërisë civile, në veçanti organizatave joqeveritare të grave, aktive në luftën kundër seksizmit, në të gjitha nivelet dhe të gjitha fushat (veçanërisht ato të përfshira në Seksionin III më poshtë) dhe të krijojnë një bashkëpunim efektiv me këto organizata.

I.A.6. Inkurajimin e organeve dhe shërbimeve përkatëse publike për shembull avokatët e popullit, komisionet e barazisë, asamblatë legjislative, institucionet shtetërore të drejtave të njeriut, ndërmarrjet publike dhe organet e ankesave, të hartojnë dhe zbatojnë kode të sjelljes ose udhëzime për seksizmin, në përputhje me një politikë gjithëpërfshirëse për eliminimin e seksizmit, dhe të sigurojnë aktivitete të tilla me burime të përshtatshme.

I.A.7. Të konsiderojnë ngritjen e një organi për barazi gjinore ose institucioni tjetër zyrtar me përgjegjësinë për monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për eliminimin e seksizmit në jetën publike dhe private. Një organ i tillë duhet të pajiset me autoritetin dhe burimet e nevojshme për të përmbushur këto detyra.

I.A.8. Sigurimin e mjeteve të efektive juridike për viktimat e sjelljes seksiste.

I.A.9. Organizimin e programeve të trajnimit për ata që punojnë me viktimat dhe autorë të krimeve që ndërliken me çështje gjinore dhe seksuale.

I.A.10. Të konsiderohet caktimi i dënimeve kundërvajtëse, për shembull tërheqjen e formave financiare dhe të tjera të mbështetjes nga organet publike ose organizata të tjera që nuk arrijnë të denoncojnë seksizmin dhe sjelljen seksiste, veçanërisht gjuhën e urretjes seksiste.

### **I.B. Masat e ndërgjegjësimit**

I.B.1. Inkurajimin e reagimeve të shpejta nga figura publike, në veçanti politikanë, udhëheqës fetarë, ekonomikë dhe të komunitetit, dhe të tjerëve që janë në pozitë të formojnë opinionin publik, të dënojnë seksizmin dhe sjelljen seksiste dhe të forcojnë pozitivisht vlerat e barazisë gjinore.

I.B.2. Inicimin, mbështjen dhe financimin e hulumtimeve, përfshirë hulumtimet bashkëpunuese në të gjithë shtetet anëtare, që sigurojnë të dhëna sistematike dhe të kategorizuara sipas gjinisë për prezencën dhe ndikimin negativ të seksizmit dhe shfaqjeve të tij, duke përfshirë seksizmin dhe ngacmimin seksual në vendin e punës, gjuhën e urretjes seksiste, objektivin, autorët, mjetet e transmetimit, mediat dhe reagimin publik. Të shpërndarjë gjerësisht dhe rregullisht këto të dhëna për autoritetet publike përkatëse,

---

<sup>4</sup> Për shembull, "Anti-Sexisme - Mode d'emploi", Institut pour l'égalité de femmes et des hommes, Belgjikë, në dispozicion në frëngjisht në [http://igvm-iefh.belgium.be/sites/default/files/shkarkime/79%20-%20Anti-seksisme%20mode%20emploi\\_FR.pdf](http://igvm-iefh.belgium.be/sites/default/files/shkarkime/79%20-%20Anti-seksisme%20mode%20emploi_FR.pdf).

institucionet arsimore dhe publikun.

I.B.3. Ndarjen e burime për të financuar fushata efektive të komunikimit dhe ndërgjegjësimit mbi lidhjet midis seksizmit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe financimin e organizatave që mbështesin viktimat.

I.B.4. Hartimin, zbatimin dhe promovimin e nismave të rregullta të ndërgjegjësimit shtetëror në të gjitha nivelet dhe përmes formave të ndryshme të mediave (për shembull përgatitjes së manualeve, udhëzimeve, videoklipeve, për transmetim në internet dhe në mediat kryesore, caktimi i një dite shtetërore kundër seksizmit, ngritja e muzeve për të festuar barazinë gjinore dhe të drejtat e grave). Këto iniciativa duhet të synojnë rritjen e vetëdijes dhe mirëkuptimit midis popullatës, veçanërisht prindërve, lidhur me format e ndryshme të seksizmit, duke përfshirë fenomene të tilla si "mansplaining"<sup>5</sup>, për mënyrën e parandalimit dhe reagimit ndaj tyre, dhe për dëmet që ata krijojnë tek individët dhe shoqëria, duke përfshirë vajzat dhe djemtë.

I.B.5. Të sigurojë përpilimin dhe zbatimin e edukimit dhe trajnimeve të përshtatura dhe të vazhdueshme për edukatorë në të gjitha sferat dhe në të gjitha nivelet e arsimit, përfshirë institucionet arsimore, personelin e burimeve njerëzore në sektorin publik dhe privat dhe në institucionet e trajnimeve profesionale (për shembull media, ushtri, profesionistët mjekësorë dhe juridikë dhe shkollat e kontabilitetit, menaxhimit dhe biznesit) lidhur me barazinë gjinore, kuptimin e stereotipeve gjinore, si të njohin dhe adresojnë seksizmin, paragjykimet dhe njëaneshmëritë dhe si të sfidohen stereotipet.

I.B.6. Të sigurojë vlerësimin e teksteve shkollore, materialeve të trajnimit dhe metodave të mësimdhënies të përdorura nga/për nxënësit e të gjitha grupmohave dhe në të gjitha format e edukimit dhe aftësimit (duke filluar me arsimin parashkollor) nëse përmbajnë gjuhë seksiste, ilustrime dhe stereotipe gjinore, dhe rishikimin e tyre me qëllim që ato të promovojnë në mënyrë aktive barazinë gjinore.<sup>6</sup>

I.B.7. Promovimin e një perspektive për barazinë gjinore, si dhe zhvillimin e mendimit kritik për luftimin e seksizmit në përmbajtje, gjuhë dhe ilustrime të lodrave, në vizatime komike, libra, televizion, video dhe lojëra të tjera, informacione dhe filma në internet përfshirë pornografinë, të cilat formojnë qëndrimet, sjelljen dhe identitetin e vajzave dhe djemve.

I.B.8. Promovimin dhe zhvillimin e fushatave të rregullta të ndërgjegjësimit për ndërtimin e feminitetit dhe maskulinitetit dhe se çfarë do të thotë të jesh grua/vajzë ose burrë/djalë në shoqërinë bashkëkohore, për shembull, përmes mediave, ligjëratave dhe diskutimeve të lira publike.

I.B.9. Inkurajimin e bashkëpunimit mes të profesionistëve (për shembull gazetarëve, edukatorëve, kuadrit të organeve të rendit) dhe organizatave të shoqërisë civile për të përcaktuar dhe shkëmbyer praktikat e mira në parandalimin dhe luftimin e seksizmit.

IB 10. Krijimin e strukturave të arritshme për të gjithë, veçanërisht për të rinjtë, për t'u ofruar atyre këshilla profesionale se si të parandalojnë, luftojnë dhe reagojnë ndaj seksizmit.

## **II. Mjete dhe masa specifike për adresimin e seksizmit dhe sjelljes seksiste në zona të caktuara**

Disa fusha të veprimtarisë janë veçanërisht të prira ndaj akteve të seksizmit dhe/ose formave specifike të sjelljes seksiste; prandaj është me rëndësi parësore që përveç masave dhe mjeteve të rekomanduara në përgjithësi, të listuara në pjesën e mëparshme, të ndërmerren veprime të planifikuara për të parandaluar dhe luftuar seksizmin në këto zona,

### **II.A. Gjuha dhe komunikimet**

Gjuha dhe komunikimi janë përbërës thelbësorë të barazisë gjinore dhe "nuk duhet ta shenjtërojnë

---

<sup>5</sup> Mansplain (folje joformale): (e një burri) për t'i shpjeguar diçka gruas në mënyrë të konsideruar si dënjuese, patronizuese, tejet bindëse ose shumë të thjeshtësuar, ose që supozon se bashkëbiseduesi nuk ka njohuri për temën.

<sup>6</sup> CEDAW, neni 10. c kërkon eliminimin e "çdo koncepti stereotip të roleve të burrave dhe grave në të gjitha nivelet dhe në të gjitha format e shkollimit elektronik ... në veçanti, nga rishikimi i teksteve shkollore dhe programeve shkollore dhe përshtatja e metodave të mësimdhënies".

hegemoninë e modelit mashkullor".<sup>7</sup> Komunikimi pa stereotipe është mënyrë e mirë për të edukuar, rritur vetëdijen dhe parandaluar sjelljen seksiste.

Ajo përfshin eliminimin e shprehjeve seksiste, përdorimin e titujve femërorë ose mashkullorë ose asnjans kur i drejtohem një grupi, duke diversifikuar përfaqësimin e grave dhe burrave dhe siguron barazinë si në pamje ashtu edhe atë përfaqësimi të tjera.

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme:

II.A.1. Të riafirmojnë dhe zbatojnë rekomandimet përkatëse ekzistuese të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare, përfshirë rekomandimin Nr.R(90)4 për eliminimin e seksizmit nga gjuha dhe Rekomandimin KM/Rek (2007)17 për standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, i cili nënvizon se "veprimet e shteteve anëtare duhet të përqendrohen në promovimin e përdorimit të gjuhës jo seksiste në të gjithë sektorët, veçanërisht në sektorin publik".

II.A.2. Të ndërmarrin një rishikim sistematik të të gjitha ligjeve, rregulloreve, politikave, etj., në kërkim të gjuhës seksiste dhe mbështetjes së supozimeve dhe stereotipeve gjinore me synimin për t'i zëvendësuar ato me terminologji të duhur gjinore. Praktikën e mira përfshijnë përgatitjen e udhëzuesve praktikë për gjuhë dhe komunikime jo seksiste e pa stereotipe gjinore për t'u përdorur në dokumentet e administratës publike.

## **II.B. Gjuha e urrejtjes seksiste në internet dhe rrjete sociale**

Seksizmi në internet është i përhapur në të gjithë Evropën, me gra të prekura në mënyrë disproporcionale - veçanërisht gratë dhe vajzat e reja, gra gazetare, politikane, figura publike dhe mbrojtëse të të drejtave njerëzore të grave. Një aspekt i seksizmit në internet është komentimi negativ i pikëpamjeve ose opinionëve të shprehura. Përderisa sulmet ndaj burrave bazohen më shpesh në mendimet ose kompetencat e tyre profesionale, gratë kanë më shumë të ngjarë të jenë subjekt i abuzimit dhe sharjeve seksiste dhe të seksualizuara, ekstremiteti i të cilave mund të thellohet nga anonimiteti i ofruar nga interneti. Sulmet në internet jo vetëm që prekin dinjitetin e grave, por gjithashtu mund të pengojnë gratë, qoftë edhe në vendin e punës, të shprehin mendimet e tyre dhe kjo rezulton me shtyrjen e tyre jashtë hapësirave në internet, duke dëmtuar të drejtën e fjalës dhe mendimit të lirë në një shoqëri demokratike, duke kufizuar mundësitë profesionale dhe duke thelluar deficitin demokratik gjinor. Aspekt tjetër është se epoka dixhitale ka thelluar vështrimin kritik të cilit i nënshtrohen trupat, fjalimet dhe aktivitetet e grave. Për më tepër, keqpërdorimi i mediave sociale - siç është postimi i materialit vizual intim pa pëlqimin e atyre që shihen - është një formë e dhunës që duhet të adresohet.

Interneti dhe mediat sociale janë të dyja mjete për lirinë e shprehjes dhe promovimin e barazisë gjinore, por ato gjithashtu u lejojnë keqbërësve të shprehin mendimet e tyre abuzive dhe të përfshihen në sjellje abuzive. Ndonëse është pranuar se gjuha e urrejtjes raciste është në kundërshtim me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, e njëjta nuk është gjithmonë e vërtetë për gjuhën e urrejtjes seksiste ose misogyniste dhe politikën dhe legjislacionin aktual në të gjitha nivelet nuk kanë qenë në gjendje ta adresojnë këtë çështje në mënyrën e duhur. Prandaj, shtetet inkurajohen të marrin përgjegjësi për luftimin e gjuhës së urrejtjes dhe të sigurojnë që të njëjtat rregulla që ekzistojnë për gjuhën e urrejtjes raciale të vihen në zbatim edhe për gjuhën e urrejtjes seksiste siç është kur bëhet fjalë për përdorimin e sanksioneve të legjislacionit penal.

Për më tepër, inteligjenca artificiale paraqet sfida në vete në lidhje me barazinë gjinore dhe stereotipet gjinore. Përdorimi i algoritmeve mund të transmetojë dhe forcojë stereotipet ekzistuese gjinore dhe në këtë mënyrë mund të kontribuojë në përjetësimin e seksizmit.

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme.

II.B.1. Zbatimin e masave legjislative që përkufizojnë dhe kriminalizojnë incidentet e gjuhës së urrejtjes seksiste dhe që aplikohen për të gjitha mediat, si dhe procedurat e raportimit dhe sanksionet e duhura. Procedurat më proaktive të zbulimit dhe raportimit të gjuhës së urrejtjes seksiste gjithashtu duhet të inkurajohen në lidhje me të gjitha mediat, përfshirë internetin dhe mediat e reja.

II.B.2. Krijimin dhe promovimin e programeve (përfshirë softuerin) për fëmijë, të rinj, prindër dhe arsimtarë për të ndihmuar në këshillimin e fëmijëve rreth edukimit medial për përdorim të sigurt dhe kritik të mediave dixhitale dhe rreth sjelljes së duhur dixhitale. Kjo duhet të bëhet përmes kurrikulës shkollore dhe përmes hartimit të manualeve dhe fletëpalosjeve lidhur me çfarë përbën sjellje seksiste, shpërndarje të

---

<sup>7</sup>Rekomandimi i Komitetit të Ministrave [Rek\(2003\)3](#) mbi pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike, Memorandum Shpjegues

padëshiruar të materialit në internet, si dhe lidhur me reagimet e duhura, përfshirë informacionin e bazuar në barazine gjinore rreth sigurisë në internet. Sigurimin e shpërndarjes së gjerë të këtyre materialeve.

II.B.3. Përgatitjen e informacioneve dhe fushatave për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me keqpërdorimin seksist të mediave sociale, kërcënimet në internet dhe situatat me të cilat përballen fëmijët dhe të rinjtë (për shembull shantazhet, kërkesat për para ose postimi i padëshiruar i fotove intime) me ndihmë praktike se si të parandalohen dhe si të reagohet në situata të tilla.

II.B.4. Organizimin e fushatave ndërgjegjësuese për publikun e gjerë mbi rreziqet, mundësitë, të drejtat dhe përgjegjësitë që lidhen me përdorimin e mediave të reja.

II.B.5. Themelimin e mjeteve nëpërmjet internetit që ofrojnë këshilla të ekspertëve se si të trajtohet seksizmi në internet, përfshirë procedurat për raportim/heqje të shpejtë të materialit të dëmshëm ose të padëshiruar.

II.B.6. Kryerjen e studimeve të rregullta dhe mbledhjen dhe kategorizimin e të dhënave sipas gjinisë dhe moshës rreth krimeve kibernetike dhe dhunës në internet dhe shpërndarjen e rezultateve në mënyrën e duhur.

II.B.7. Integrimin e një perspektive të barazisë gjinore në të gjitha politikat, programet dhe hulumtimet në lidhje me inteligjencën artificiale për të shmangur rreziqet e mundshme të teknologjisë që përjetësojnë seksizmin dhe stereotipet gjinore dhe të gjendet mënyra si inteligjenca artificiale do të mund të ndihmonte në ngushtimin e dallimeve gjinore dhe eliminimin e seksizmit. Kjo përfshin masa për të rritur pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në fushën e informacionit dhe teknologjisë si studentë, profesionistë dhe vendimmarrës. Dizajnimi i instrumenteve dhe algoritmeve të bazuara në të dhëna duhet të jenë faktor në dinamikën e bazuar në gjini. Transparenca rreth këtyre çështjeve duhet të përmirësohet dhe të rritet ndërgjegjësimi për paragjykimet e mundshme gjinore në të dhëna të mëdha; gjithashtu duhet të ofrohen zgjidhje për të përmirësuar lraportimin.

## **II.C. Produkte dhe shërbime në media, reklamime dhe komunikime të tjera**

Seksizmi në media - elektronike, të shtypit, transmetuese dhe audio - kontribuon në krijimin e një mjedisi që toleron dhe banalizon seksizmin "e përditshëm". Ai shprehet përmes:

- përshkrimeve seksuale, seksualizuese dhe raciale të grave, burrave, vajza dhe djemtë, përfshirë në reklama, filma, televizion, video lojëra dhe materiale pornografike;
- raportimeve përçmuese ose minimizuese për pamjen, veshjen dhe sjelljen e grave, në vend të diskutimeve të barazpeshuara dhe të informuara rreth pikëpamjeve dhe mendimeve të tyre;
- prezantimit dhe imagjinimit të grave dhe burrave në role stereotipike brenda familjes dhe komunitetit;
- riprodhimit dhe përforcimit të stereotipeve gjinore në lidhje me viktimat e dhunës me bazë gjinore;
- përfaqësimit jo të barabartë dhe mungesës së pjesëmarrjes domethënëse të grave në role të ndryshme profesionale dhe informuese (eksperte, komentuese), veçanërisht në lidhje me gratë e pakicave.<sup>8</sup>

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme:

II.C.1. Ofrimin e legjislacionit që ndalon seksizmin në media dhe reklamim dhe që inkurajon monitorimin dhe zbatimin e masave të tilla.

II.C.2. Promovimin e përfshirjes së shprehjeve të seksizmit në ligjet kundër shpifjes.

II.C.3. Inkurajimin dhe sigurimin e mbështetjes për pjesëmarrjen e sektorëve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të mediave dhe reklamave në hartimin, miratimin dhe zbatimin e politikave dhe mekanizmave të vetërregullimit për eliminimin e seksizmit, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes seksiste brenda secilit sektor.

---

<sup>8</sup> Shih gjetjet dhe rekomandimet e Konferencës së Këshillit të Evropës për Media dhe Imazhit të Grave (Amsterdam, 4-5 korrik 2013). Shihni raportin e konferencës në <https://rm.coe.int/1680590fb8>.

II.C.4. Promovimin e rolit të kontrollit të mediave dhe organizatave reklamuese në adresimin e seksizmit.

II.C.5. Inkurajimin e krijimit të një institucioni që është kompetent për të pranuar, analizuar dhe shqyrtuar ankesat në lidhje me seksizmin në media dhe reklamim, i cili ka edhe autoritetin të kërkojë që përmbajtja apo reklammat seksiste të tërhiqen ose modifikohen.

II.C.6. Inkurajimin e organeve përkatëse, siç janë komisionet për barazi gjinore ose institucionet shtetërore për të drejtat e njeriut që të krijojnë strategji dhe instrumente për edukim dhe trajnim të gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë në fushën e komunikimit për njohjen e seksizimit dhe për mënyrat e promovimit pozitiv dhe pa stereotipe të portreteve të burrave dhe grave në reklamime si dhe mënyrat e promovimit të komunikimit që merr parasysh aspektet gjinore. Për këto aktivitete shtesë duhet të sigurohen financimet e duhura.

II.C.7. Mbështetjen e hulumtimeve mbi përhapjen dhe ndikimin e portretizimeve seksiste të grave dhe vajzave në media dhe në materiale pornografike, deri në çfarë mase ato përkeqësojnë pabarazitë gjinore dhe dhunën ndaj grave dhe vajzave dhe gjithashtu mbi ndikimin e tyre në shëndetin fizik, seksual dhe psikologjik të grave. Atribuimin e burimeve financiare të nevojshme për fushata efektive të komunikimit dhe ndërgjegjësimit mbi lidhjet midis seksizmit, mungesës së barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave; si dhe promovimin e portreteve pozitive dhe jo stereotipizuese ndaj grave dhe burrave në media dhe reklamim.

II.C.8. Inkurajimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në pozita vendimmarrëse në media dhe në përmbajtje dhe krijimin e bazave të të dhënave të eksperteve gra për të gjitha temat.

II.C.9. Miratimin e masave pozitive për përsosmëri dhe udhëheqje në promovimin e përfaqësimit të ekuilibruar gjinor, siç është një sistem i bazuar në rezultate për shpërndarjen e fondeve shtesë për mediat që prodhojnë përmbajtje që tregon ndjeshmëri ndaj aspekteve gjinore.

II.C.10. Inkurajimin e promovimit të imazheve pozitive të grave si pjesëmarrëse aktive në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike dhe imazheve pozitive të burrave në role jo tradicionale siç janë kujdestarët. Sigurimin e stimujve ose shpërblimeve për praktikë të mirë, për shembull përmes financimit publik.

II.C.11. Mbështetjen dhe promovimin e praktikave të mira përmes dialogut dhe zhvillimit të rrjeteve dhe partneriteteve midis partnerëve të mediave për të luftuar më tej seksizmin dhe stereotipet gjinore brenda sektorit.

II.C.12. Mbështetjen e projekteve që adresojnë diskriminimin e shumëfishtë dhe të tërthortë ndaj grave në situata të brishta. Aplikimin e stimulimeve për mediat për të promovuar imazhe pozitive të grave nga pakicat etnike dhe/ose me prejardhje emigruese.

## II. D. Vendi i punës

Seksizmi në vendin e punës shfaqet në forma të ndryshme dhe është i pranishëm si në sektorin publik ashtu dhe atë privat. Ai manifestohet përmes komenteve seksiste dhe sjelljes që kundërshtojnë një punonjësi ose një grupi punonjësish. Seksizmi në vendin e punës përfshin, mes tjerash, komente përçmuese, objektivizimin, humorin ose shakatë seksiste, komentet e pahijshme, heshtjen ose injorimin e njerëzve, komentet e panevojshme për veshjen dhe pamjen fizike, gjuhën seksiste trupore, mungesën e respektit dhe praktikat mashkullore që frikësojnë ose përjashtojnë gratë dhe favorizojnë burrat e tjerë.<sup>9</sup> Kjo ndikon në barazinë dhe dinjitetin në punë.<sup>10</sup>

Supozimet seksiste të bazuara në role tradicionale gjinore mund të rezultojnë në besimin se gratë, si nëna, nëna të ardhshme ose kujdestare, janë kolege dhe punonjëse më pak të besueshme. Në të kundërtën, mund të ketë sjellje të ashpër ndaj nënave që nuk qëndrojnë në shtëpi ose, përndryshe, ato mund të përjashtohen nga mundësi të rëndësishme për të përparuar në karrierën e tyre, dhe si pasojë, jetën e tyre profesionale. Kjo kontribuon në krijimin e pengesave që kufizojnë mundësitë e promovimit të grave. Supozime të tilla mund të rezultojnë edhe me komente seksiste ndaj burrave që marrin përgjegjësi të kujdestarisë.

Disa ambiente të caktuara në vendin e punës janë të dominuara nga meshkujt, me një rrezik të lartë të kultivimit të një kulture seksiste. Për më tepër, gratë në pozita vendimmarrëse ose ato që perceptohen si

9 Këshilli i Lartë për barazi profesionale midis burrave dhe grave (2016), "Pako veprimesh kundër seksizmit - Tri mjete për botën e punës", në dispozicion në <https://rm.coe.int/16806fbde>.

10 Neni 26.2 i Kartës Sociale Evropiane (të rishikuar) kërkon që palët "të promovojnë vetëdijen, informacione dhe parandalimin e veprimeve të përsëritura ose haptazi të qarta negative dhe fyese të drejtuara kundër punëtorëve individualë në vendin e punës ose në lidhje me punën dhe të marrin të gjitha masat e duhura për të mbrojtur punëtorët nga një sjellje e tillë".

sfiduese të hierarkisë institucionale të dominuar nga meshkujt, mund të jenë veçanërisht objekt i seksizmit. Ngjajshëm, burrat mund të përjetojnë seksizëm në vende të punës të dominuara nga gratë, ose vetëm pse janë punësuar në punë që janë tipike për "femra".

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme:

II.D.1. Rishikimin e legjislacionit të punës për të ndaluar seksizmin dhe aktet seksiste në punë dhe promovimin e praktikave të mira siç janë analiza e rreziqeve, masat zbutëse dhe menaxhuese, mekanizmat e ankesave, mjetet juridike për viktimat dhe veprimet disiplinore përmes proceseve të së drejtës civile ose administrative.

II.D.2. Inkurajimin dhe sigurimin e mbështetjes për rishikim sistematik të rregullave, politikave dhe rregulloreve brenda institucioneve të sektorit publik dhe privat, me qëllim të miratimit të kodeve të përshtatshme të sjelljes që përfshijnë mekanizmat e ankesave dhe masat disiplinore në lidhje me seksizmin dhe aktet seksiste. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë forma të ndërthurura të seksizmit, për shembull, përkitazi me statusin e migrantit ose aftësite e kufizuara.

II.D.3. Inkurajimin e profesioneve të pavarura, organizatave dhe sindikatave profesionale që të bashkohen në luftën kundër seksizmit brenda organizatave të tyre dhe ta përfshijnë atë në rregullat e tyre të brendshme.

II.D.4. Përgatitjen dhe vënien në dispozicion të gjerë të një pakete mjetesh për ta luftuar seksizmin, përfshirë dispozitat përkatëse legjislative dhe shpjegime për përfitimet institucionale të eliminimit të seksizmit dhe shembuj të akteve seksiste dhe praktikave të mira për eliminimin e seksizmit. Punëdhënësve dhe menaxherëve, përfaqësuesve të sindikatave dhe personelit tjetër relevant duhet t'u tërhiqet vëmendja për detyrimin e tyre për të eliminuar seksizmin në vendin e punës dhe për veprimet korrigjuese në dispozicion për viktimat.

II.D.5. Kërkimin e angazhimit nga niveli më i lartë (në sektorin publik dhe privat) për promovimin e një kulture institucionale që refuzon seksizmin brenda vendit të punës, për shembull përmes hartimit të politikave të barazisë, udhëzimeve të brendshme dhe fushatave për forma të ndryshme të seksizmit dhe shpërbërjes së stereotipeve, rritjes së numrit të grave në pozitat e vendimarrjes dhe thyerjes së pengesave, përfshirë edhe përmes masave speciale të përkohshme, siç janë caqet dhe kuotat.

II.D.6. Kërkimin e angazhimit nga niveli më i lartë (në sektorin publik dhe privat) për të promovuar ndergjegjësimin, informacionin dhe parandalimin në lidhje me sjelljen seksiste dhe marrjen e të gjitha masave e duhura për të mbrojtur punonjësit nga një sjellje e tillë.

## **II.E. Sektori publik**

Seksizmi në sektorin publik dhe mbështetja në stereotipe gjinore mund të rezultojnë në refuzimin e shërbimeve publike dhe qasje të pabarabartë në burime. Në të njëjtën kohë, gratë që punojnë në sektorin publik, përfshirë ato të zgjedhura ose anëtare të organeve vendimmarrëse, në të gjitha nivelet, shpesh përballen me sfida ndaj dinjitetit, legjitimitetit dhe autoritetit të tyre për shkak të seksizmit dhe sjelljes seksiste.<sup>11</sup>

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme:

II.E.1. Përfshirjen e dispozitave kundër seksizmit dhe sjelljeve seksiste dhe gjuhës në kode dhe rregullore të brendshme të sjelljes, me sanksione të përshtatshme për ata që punojnë në sektorin publik, duke përfshirë asamblëtë e zgjedhura.

II.E.2. Mbështetjen e iniciativave dhe hetimeve të ndërmarra nga parlamentarët, organizatat e shoqërisë civile, sindikatat ose aktivistët për ta adresuar seksizmin në sferën publike.

II.E.3. Promovimin e përfshirjes së dispozitave për barazi gjinore brenda kornizës ligjore në fuqi si praktikë

---

<sup>11</sup> Për shembull, sipas një studimi në vitin 2018 nga Unioni Ndërparlamentar dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, 85% e grave parlamentare të anketuara kanë përjetuar dhunë psikologjike në parlament; gratë parlamentare nën 40 vjeç kishin më shumë gjasa të ngacmohen; gratë e stafit parlamentar pësuan më shumë dhunë seksuale sesa gratë parlamentare; dhe shumica e parlamenteve nuk kishin mekanizma për t'ua mundësuar grave të flasin. Asambleja Ndërparlamentare dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (2018), "Seksizmi, ngacmimi dhe dhuna ndaj grave në parlamentet në Evropë", gjendet në [www.ipu.org/resources/publications/reports/2018-10/seksizem-ngacmim-dhe-violence-kundër-gratë-parlamentet-në-Evropë](http://www.ipu.org/resources/publications/reports/2018-10/seksizem-ngacmim-dhe-violence-kundër-gratë-parlamentet-në-Evropë).



e mirë publike e tenderimit/prokurimit.

II.E.4 Sigurimin e trajnimit të punonjësve të sektorit publik për rëndësinë e sjelljes jo-seksiste në punën me publikun, si dhe me kolegët në vendin e punës. Një trajnim i tillë duhet të përfshijë përkufizimin e seksizmit, manifestimet e ndryshme të tij, mënyrat për t'i dekonstruktuar stereotipet gjinore dhe paragjykimet dhe mënyrën si të reagohet ndaj tyre.

II.E.5. Informimin e p të shërbimeve publike për të drejtat e tyre në lidhje me sjelljen jo-seksiste përmes, për shembull, fushatave sensibilizuese dhe skemave specifike të raportimit për të identifikuar dhe ndërmjetësuar problemet e mundshme.

II.E.6. Promovimin e forcimit dhe zbatimit të masave të brendshme disiplinore për seksizmin në sektorin publik dhe në të gjitha organet vendimmarrëse dhe politike, për shembull përmes shkurtimit ose pezullimit të përgjegjësive dhe fondeve, ose përmes gjobave financiare.

## II.F. Sektori i drejtësisë

Seksizmi dhe stereotipizimi gjinor brenda sistemit të drejtësisë civile, administrative dhe penale dhe zbatimit të ligjit janë pengesa për administrimin e drejtësisë. Kjo mund të rezultojë në nxjerrjen prej vendimmarrësve të vendimeve të keqinformuara ose diskriminuese të bazuara në dogma dhe paragjykime të paracaktuara dhe jo në fakte relevante.<sup>12</sup>

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme:

II.F.1. Duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit, të sigurohen trajnime të rregullta dhe adekuate për të gjithë gjyqtarët dhe kuadrot e gjyqësorit për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, si dhe dëmet e shkaktuara nga paragjykimet gjinore dhe stereotipat gjinore dhe përdorimi i gjuhës seksiste, veçanërisht në rastet që përfshijnë dhunën ndaj grave dhe vajzave.<sup>13</sup>

II.F.2. Sigurimin e trajnimit të të gjithë personelit të zbatimit të ligjit mbi seksizmin, krimet kibernetike, gjuhën e urrejtjes seksiste dhe dhunën ndaj grave; lehtësimin e raportimit të sjelljeve të tilla në polici; dhe rritjen e kompetencave të policisë për të kapur dhe siguruar prova të abuzimit në internet.

II.F.3. Inkurajimin e gjykatave përfshire ato vendore dhe ndërkombëtare që të pranojnë intervenimet nga palët e treta dhe mendimet e ekspertëve për tema të panjohura, siç është seksizmi dhe stereotipizimi gjinor.

II.F.4. Garantimin që sistemet për raportimin e shkeljeve dhe qasjes në organet e zbatimit të ligjit të jenë të sigurta, të disponueshme dhe të përshtatshme; lehtësimin e ngarkesave financiare ose pengesave të tjera që parandalojnë viktimat të raportojnë ose ndjekin raste në forumin e duhur. Ndërmarrjen e hapave për të adresuar rrezikun e riviktimizimit.

II.F.5. Inkurajimin e organeve profesionale ligjore për të organizuar ligjërata publike dhe ngjarje të tjera për të rritur ndërgjegjësimin midis profesionistëve juridikë dhe palëve të tjera të interesuara për seksizmin dhe stereotipizimin gjinor në sistemin e drejtësisë.

## II.G. Institucionet arsimore

Mesazhet seksiste formësojnë shoqërinë tonë dhe janë të mbrujtura dhe riprodhuara nga sistemet arsimore, në vend që të sfidohen. Fëmijët dhe të rinjtë asimulojnë stereotipet gjinore përmes kurrikulave, materialeve mësimore, sjelljes dhe gjuhës.<sup>14</sup> Seksizmi mund të jetë i ngulitur në kulturën e institucioneve arsimore në të gjitha nivelet, nga institucionet parashkollore deri në institucionet terciare. Ai mund të shfaqet në forma nga më të ndryshmet, për shembull: tolerimi dhe konsiderimi si të parëndësishme i imazheve, gjuhës dhe shprehjeve seksiste, mos-tolerimi i sjelljes gjinore jo-konformiste; mos-adresimi i paragjykimeve të pavetëdijshme nga stafi dhe studentët; mekanizmat e ankesave dhe regjistrimit të rasteve ose mungojnë ose nuk janë të duhurit; mungesa e sanksioneve për ngacmimin seksual, përfshirë edhe nga studentë të tjerë. Këto forma të ngulitura të seksizmit mund të ndikojnë në arsimimin, karrierën dhe zgjedhjet e mëvonshme të stilit të jetës. Shtetet gjithashtu mbajnë përgjegjësi për të siguruar llogaridhënie të institucioneve private për veprimet e tyre dhe nuk duhet të bëjnë përjashtime as për

12 "Plani i Veprimit i Këshillit të Evropës për Forcimin e Pavarësisë Gjyqësore dhe Paanshmërisë" ( CM (2016) 36-final ), "të gjitha përpjekjet duhet të merren për të luftuar stereotipizimin gjinor brenda vetë gjyqësorit" (Veprimi 2.4); OHCHR, "Eliminimi i stereotipeve gjyqësore - Qasje e barabartë në drejtësi për gratë në rastet e dhunës me bazë gjinore", 9 qershor 2014.

13 Shih Këshilli i Evropës (2017), "Manual për gjyqtarët dhe prokurorët për sigurimin e qasjes së grave në drejtësi", gjendet në <https://rm.coe.int/training-manual-women-access-to-Justice/16808d78c5>.

14 Shih përfundimet dhe rekomandimet e Konferencës së Këshillit të Evropës "Lufta kundër stereotipeve gjinore në dhe përmes arsimit" (Helsinki, 9-10 Tetor 2014). Shihni raportin e konferencës në <https://rm.coe.int/1680590f0>.

institucionet e arsimit fetar.

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme:

II.G.1. Zbatimin e plotë të dispozitave të Rekomandimit KM/Rek(2007)13 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për respektimin e çështjeve gjinore në arsim.

II.G.2. Sigurimin e përfshirjes së barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit dhe eliminimit të seksizmit dhe sjelljes seksiste në të gjitha aspektet e procesit arsimor, duke përfshirë mekanizmat dhe udhëzimet për raportim, reagim dhe regjistrim të incidenteve.

II.G.3. Implementimin dhe/ose mbështetjen e fushatave parandaluese në lidhje me seksizmin dhe sjelljen seksiste në institucionet arsimore dhe sigurimin e tolerancës zero për fenomene të tilla, përfshirë stereotipizimin gjinor dhe bulizmin, sulmin në internet, sulmet seksiste dhe dhunën me bazë gjinore.

II.G.4. Organizimin e aktiviteteve, përfshirë dhe ato përmes organeve shtetërore, që adresojnë çështjet e barazisë gjinore dhe mënyrat e parandalimit dhe luftimit të seksizmit, stereotipet gjinore dhe paragjykimet e pavetëdijshme gjinore në të gjitha institucionet arsimore.

II.G.5. Integrimin e një perspektive të barazisë gjinore në të gjitha aspektet e formimit të mesueseve para fillimit si dhe gjatë punës, si dhe në kurset e personelit menaxhues të shkollës.

Në lidhje me metodologjinë e mësimdhënies, mjetet dhe kurrikulat:

II.G.6. Përgatitjen e udhëzimeve për të siguruar integrimin e barazisë gjinore, mosdiskriminimin dhe metodologjinë për mësimdhënien e të drejtave të njeriut dhe mjeteve në kurrikula në të gjitha nivelet e arsimit, si publik ashtu edhe privat, që nga fëmijëria e hershme. Kjo përfshin edukimin për jetën private, në mënyrë që të inkurajohen fëmijët të kenë vetëbesim dhe të rritin përgjegjësinë në marrëdhëniet dhe sjelljen e tyre - përfshirë miratimin dhe kufijtë personalë. Kurrikulat duhet të përmbajnë edukimin seksual dhe të seksualitetit të përshtatshëm për moshën, të bazuar në dëshmi dhe shkencërisht të sakta dhe gjithëpërfshirëse për vajzat dhe djemtë. Kurrikula gjithashtu duhet të përfshijë forma të ndërthurura të seksizmit, të bazuara, për shembull, në statusin e emigruesit ose aftësitë e kufizuara.

II.G.7. Inkurajimin e krijimit të një faqe të internetit me informacione, praktika të mira dhe materiale për mësimdhënie/nxënie dhe një manual për të ndihmuar në dallimin dhe eliminimin e stereotipeve gjinore në materialet edukative për trajnuesit, mësuesit dhe inspektorët.

II.G.8. Promovimin e programeve speciale dhe këshillimeve për karrierë që ndihmojnë studentët për të bërë zgjedhje për studime dhe karrierë të cilat nuk bazohen në stereotipe gjinore, përfshirë trajnimin për stafin rreth stereotipeve gjinore dhe paragjyqimeve të pavetëdijshme.

## **II.H. Kultura dhe sporti**

Seksizmi shfaqet në shumë aspekte të jetës kulturore, sidomos përmes përhapjes së stereotipeve gjinore. Sipas Komitetit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, jeta kulturore përfshin mënyrat e jetës, gjuhën, letërsinë gojore dhe të shkruar, muzikën dhe këngën, komunikimin joverbal, sistemet e fesë ose besimit, ritet dhe ceremonitë, sportet e lojërat, metodat e prodhimit ose teknologjisë, mjediset natyrore dhe të krijuara nga njeriu, ushqimin, veshmbathjen dhe strehimin, artin, zakonet dhe traditat. Arti dhe kultura janë formues thelbësorë të qëndrimeve dhe roleve gjinore dhe për këtë arsye është e rëndësishme të adresohet seksizmi në këto fusha. Veç kësaj, sipas Konventës së Stambollit, kultura, feja, zakonet ose tradita nuk do të konsiderohen si justifikim për akte të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Çështjet që duhet të adresohen në jetën sportive përfshijnë: qëndrimet seksiste të mediave, organizatave sportive, trajnerëve, drejtuesve të sportit, atletëve, etj. ; portretizimet seksiste të grave në sport, duke u tallur me arritjet sportive të grave duke i përshkruar ato në role stereotipike ose duke përlulur sportet e tyre; dhe seksizmin dhe gjuhën e urrejtjes seksiste në ngjarje sportive.

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme:

II.H.1. Përgatitjen dhe promovimin e mjeteve për ta luftuar seksizmin në sektorët kulturorë dhe sportivë, siç janë materiali trajnues ose mjetet për gjuhën dhe komunikimin me nuanca gjinore.

II.H.2. Riafirmimin dhe zbatimin e Rekomandimit KM/Rek(2015)2 të Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare mbi integrimin gjinor në sport dhe KM/Rek (2017)9 të Komitetit të Ministrave të shteteve

---

anëtare mbi barazinë gjinore në sektorin audiovizual.

II.H.3. Inkurajimin e personaliteteve të njohura kulturore dhe sportive për të korrigjuar supozimet seksiste ose për ta denoncuar gjuhën e urrejtjes seksiste.

II.H.4. Inkurajimin e federatave sportive dhe shoqatave e institucioneve kulturore në të gjitha nivelet të përgatisin kode të sjelljes për të parandaluar seksizmin dhe sjelljen seksiste të cilat duhet të përfshijnë dispozita për masa disiplinore. Nxitjen e tolerancës zero ndaj seksizmit dhe gjuhë së urrejtjes seksiste në ngjarje kulturore dhe sportive.

II.H.5. Inkurajimin e sektorëve sportivë dhe kulturorë në të gjitha nivelet për ndërmarrjen e veprimeve konkrete për të promovuar barazinë gjinore dhe portretizimin pa stereotipe të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

II.H.6. Promovimin e transmetimit dhe mbulimit nga mediat, veçanërisht mediat publike, të ngjarjeve kulturore dhe sportive të grave në mënyrë të barabartë me ato të burrave, dhe kremtimin publik të arritjeve të grave.<sup>15</sup> Rritjen e vizibilitetit dhe promovimin pozitiv të modeleve pozitive të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, të cilët marrin pjesë në sporte ku ata nuk janë të përfaqësuar mjaftueshëm.

## II.I. Sfera private

Seksizmi brenda familjes mund të kontribuojë në forcimin e roleve stereotipike, shfuqizimin e grave, në vlerësimin e ulët të vetes, si dhe në ciklin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Mund të ndikojë gjithashtu në jetën dhe zgjedhjet e karrierës. Ndonëse rolet tradicionale gjinore brenda familjes (burrat si mbajtës të familjes, gratë që kryejnë detyrat shtëpiake) në përgjithësi janë zhvendosur pasi më shumë gra kanë hyrë në fuqinë punëtore me pagesë, faktorët që kontribuojnë në ndryshime në familje dhe shtete janë të ndryshëm. Sjellja seksiste mbetet e përhapur në marrëdhëniet ndër njerëzore dhe gratë vazhdojnë të kryejnë më shumë punë të papaguara në shtëpi sesa burrat.

Neni 16 CEDAW kërkon që Shtetet palë të marrin masat e duhura për të siguruar barazinë midis grave dhe burrave brenda familjes.<sup>16</sup> Lidhja midis seksizmit dhe parandalimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave forcon nevojën për të ndërmarrë veprime në sferën private.

Masat e rekomanduara më lart, veçanërisht ato në lidhje me gjuhën dhe ndërgjegjësimin, si dhe ato në lidhje me median, arsimin dhe sektorët kulturorë, janë veçanërisht të rëndësishme për adresimin e seksizmit në sferën private.

Megjithatë, sanksionet për seksizëm brenda familjes janë të papërshtatshme, përveç nëse sjellja arrin pragun e kriminalitetit siç është dhuna fizike, psikologjike apo ekonomike ndaj grave.

Qeveritë e shteteve anëtare ftohen të marrin në konsideratë masat e mëposhtme:

II.I.1. Caktimin e masave në lidhje me harmonizimin mes jetës private dhe asaj profesionale, duke përfshirë lejen me pagesë pas lindjes për gratë dhe burrat, lejen e paguar prindërore për gratë dhe burrat mundësi universale për kujdes ndaj fëmijëve dhe shërbime të tjera sociale, cilesore dhe të perballueshme financiarisht, dhe rregullime fleksibile në lidhje me punën si për gratë ashtu edhe për burrat. Përmirësimin e aksesit në shërbime për sa i përket kujdesit për të moshuarit dhe personave të tjerë që janë në varësi. Organizimin e fushatave për të inkurajuar ndarjen e barabartë të përgjegjësisë shtëpiake dhe të kujdesit midis grave dhe burrave.

II.I.2. Promovimin e politikave dhe masave që mbështesin prindërimin pozitiv të cilat garantojnë mundësi të barabarta për fëmijët pa marrë parasysh gjininë, statusin, aftësitë ose situatën e familjes. Prindërimi pozitiv i referohet sjelljes prindërore bazuar në interesat më të mira të fëmijës, sjellje që është ushqyese, fuqizuese por e zhveshur nga stereotipet, pa dhunë, dhe që ofron një orientim që njih dhe perfshin caktimin e kufijve si mjet për zhvillimin e plotë të fëmijës.

II.I.3. Prezantimin e masave dhe mjeteve për të rritur aftësitë e prindërve për ta trajtuar seksizmin dhe pornografinë në internet.

II.I.4. Promovimin e trajnimit për njohjen dhe adresimin e seksizmit dhe sjelljes seksiste si pjesë e kurseve profesionale për ata që merren me marrëdhënie familjare dhe ndërnjerëzore, për shembull,

---

<sup>15</sup> Të ngjashme si faqja "Kjo Vajzë Mundet", e cila vë në dukje gratë aktive ([www.thisgirlcan.co.uk/](http://www.thisgirlcan.co.uk/)).

<sup>16</sup> Përveç kësaj, neni 2.e CEDAW kërkon që Shtetet të ndërmarrin "të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin ndaj grave nga çdo person, organizatë ose ndërmarrje".

personelin e shërbimeve sociale, përfshirë qendrat e maternitetit dhe kujdesit ndaj fëmijëve.

---

### III. Raportimi dhe vlerësimi

Ky Rekomandim u kërkon Shteteve Anëtare të monitorojnë progresin në zbatimin e tij dhe të informojnë Komitetin(et) Drejtues(e) kompetent(e) për masat e marra dhe progresin e arritur.

Raportimi duhet të jetë i rregullt dhe të përfshijë informacione për:

- kornizat ligjore dhe të politikave, masat dhe praktikat më të mira që adresojnë seksizmin, sjelljen seksiste, stereotipizimin gjinor dhe gjuhën e urrejtjes seksiste, veçanërisht në hapësirat publike, internetin dhe mediat, vendin e punës, sektorin publik, drejtësinë, sektorët e arsimit dhe sportit dhe kultures, dhe sferën private, duke përfshirë mjetet për raportimin e sjelljes seksiste, si dhe masat disiplinore dhe sanksionet;
- çdo politikë gjithëpërfshirëse, ose politikë brenda kornizës së një strategjie kombëtare për barazinë gjinore, e miratuar për të eliminuar seksizmin dhe sjelljen seksiste, përfshirë përkufizimet, treguesit, mekanizmat kombëtarë të monitorimit dhe vlerësimit;
- punën e çdo organi bashkërendues të krijuar ose të caktuar për të monitoruar zbatimin në nivelin kombëtar;
- hulumtime të ndërmarra dhe të mbështetura për të siguruar të dhëna mbi incidencën dhe pasojat e seksizmit dhe sjelljes seksiste në zonat e synuara, si dhe rezultatet e ndonjë studimi të tillë;
- masa ndërgjegjësimi dhe fushata kombëtare të ndërmarra në të gjitha nivelet, përfshirë ato në media përmes të cilave ato u realizuan.

Lëvizjet e fundit si #MeToo kanë rritur ndërgjegjësimin për seksizmin e vazhdueshëm e të përhapur gjithandej në të gjithë sektorët e shoqërisë. Si përgjigje, Këshilli i Evropës ka miratuar Rekomandimin KM Rek(2019)1 për parandalimin dhe luftimin e seksizmit. Ky tekst i veçantë përmban për herë të parë përkufizimin juridik ndërkombëtar të seksizmit. Rekomandimi bën lidhjen midis akteve të "seksizmit të përditshëm" dhe dhunës ndaj grave, si pjesë e një vazhdimësie që krijon një klimë kanosjeje, frike dhe diskriminimi, duke prekur kryesisht gratë dhe vajzat. Teksti synon të hedhë dritë mbi sjelljen seksiste dhe përcakton mënyra konkrete për qeveritë dhe palët e tjera të interesuara për ta adresuar atë.

SQI

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ne të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikqyr zbatimin e konventës nga shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)